



Prishtinë, 29.01.2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1866\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23** i dt.15.12.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **09.01.2024**.

në seancën e mbajtur më datë **29.01.2024** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin S.K nga komuna e Gjakovës, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23 i dt.15.12.2023.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 15.12.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 25.08.2023 lidhur me kontestimin e faturimit me njehsorin elektrik nr. 08193439, për shkak të dyshimit në matje dhe faturim jo të saktë.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi i konsumatorit është real;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23 i datës 15.12.2023 për konsumatorin S.K

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e KESCO se vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23 i datës 15.12.2023 i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nuk është i drejtë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha



provave dhe shkresave si: Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0012443 datë 01.02.2022; Protokoli i verifikimit të njehsorit elektrik-mekanik në qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 6229 datë 19.07.2023; Ankesa e konsumatorit në KESCO date 27.04.2021 dhe 20.01.2022; përgjigja e KESCO-s date 02.11.2021 dhe 25.08.2023 Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 18.10.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_2477\_12\_23 i datës 15.12.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm

ZRrE ka vërejtur se, konsumatori me datë 20.01.2022 ka përsëritur ankesën për dyshim në matjen dhe faturimin e shpenzimeve mujore me njehsorin elektrik nr. 08193439 pasi që edhe me herët përkatësisht me datë 27.04.2021 ka bërë të njëjtën ankesë dhe me date 02.11.2021 KESCO i është përgjigjur duke e refuzuar ankesën e tij. Sipas analizës së përgjigjes së lëshuar nga KESCO të datës 02.11.2021 vërtetohet se pika matëse e konsumatorit përkatësisht njehsori elektrik nuk është inspektuar por që përgjigja i është lëshuar me argumentet se njehsori ka lexime të rregullta dhe se lexuesi asnjëherë nuk ka evidentuar ndonjë problem.

Pas ankesës së datës 20.01.2022, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 01.02.2022 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 08193439 me gjendje TL=051847 kWh dhe TU=023164 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20088581 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kanë evidentuar se bëhet ndërrimi i njehsorit të vjetër për shkak të çrregullimit të datës dhe orës, dhe se njehsori i vjetër dërgohet për shqyrtim në institut të Prishtinës.

Bordi i ZRRE ka vërejtur se pas ndërrimit të njehsorit kontestues, me datë 19.07.2023 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 08193439 me gjendje të shpenzimeve TL=051852 kWh dhe TU=023164 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik nuk ka probleme me sistemet e fazave të matjes, njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, njehsori elektrik të shkojë në asgjësim nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka kurse gabimi në matje është **-0.63%**. Në procesverbal po ashtu është evidentuar vërejtja se: njehsori elektrik është pa llogo të KEDS.

Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se vetëm në disa periudha ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik si dhe ka evidentuar që sugjerim për zhvendosje. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike si dhe shpenzimet e konsumatorit me dy njehsorët elektrik, njehsorin kontestues nr. 08193439 dhe njehsorin e ri nr. 20088581 konstatohet se konsumatori nuk ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike por që ka dallim në kohën e shfrytëzimit. Sipas rrjedhës së energjisë mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër kontestues nr. 08193439 për periudhën 02/2018 deri në periudhën 11/2019 është **669 kWh/muaj** kurse shpenzimi në tarifën e lartë është **68%** dhe tarifën e ulët është **32%**, periudhën 02/2020 deri në periudhën 11/2021 është **902 kWh/muaj** kurse shpenzimi në tarifën e lartë është **71%** dhe tarifën e ulët është **29%**, kurse me njehsorin e ri nr. 20088581 periudha 02/2022 deri në periudhën 11/2023 është **814 kWh/muaj** kurse shpenzimi në tarifën e lartë është **39%** dhe tarifën e ulët është **61%**.

ZRRE gjatë analizimit të dy procesverbaleve, procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0012443 datë 01.02.2022 dhe protokollit të verifikimit të njehsorit elektrik-mekanik në qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 6229 datë 19.07.2023 konstaton se ka mos përputhje për shkak se ekipet e KEDS të cilët kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 08193439 kanë evidentuar në procesverbal se njehsori elektrik ka të çrregulluar datën dhe orën që nënkupton se i njëjti nuk ka mundur të bëjë regjistrime të sakta të kohës së shpenzimeve të konsumatorit kurse në protokollin e



shqyrtimit është evidentuar vetëm vërejtja se njehsori elektrik nuk ka llogo, duke mos u potencuar edhe problemi i mundshëm me kohën e regjistrimit të shpenzimeve në njehsorë. Bazuar në këto kundërtënie si dhe rrjedhës së energjisë elektrike ZRRE konstaton se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhës kontestuese si dhe atyre të më hershme ka nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRRE bazuar në analizën e transaksioneve si dhe rrjedhës së energjisë elektrike vëren se njehsori elektrik nr. 08193439 është vendosur për matje në periudhën 06/2013 me gjendje TL=7716 kWh dhe TU=3,410 kWh. ZRRE duke marrë për bazë ankesat e konsumatorit si dhe mos inspektimin me kohë të njehsorit elektrik sipas kërkesës së konsumatorit si dhe shpenzimet e tanishme e në veçanti duke e pasur parasysh se njehsori elektrik nr. 08193439 ka qenë elektronik dhe që me rastin e vendosjes për matje ka pasur kWh të regjistruar si dhe duke pasur parasysh programimin e kohës tarifore të shpenzimit sipas strukturës tarifore të aprovuar nga ZRRE konstaton se konsumatorit duhet të behet ri kalkulimi i të gjitha faturave nga periudha e vendosjes për matje 06/2013 deri në periudhën e ndërrimit 01.02.2022 sipas kohës së tanishme të shpenzimeve të regjistruara në njehsorin e ri elektrik nr. 20088581 tarifën e lartë është **39%** dhe tarifën e ulët është **61%**.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e në veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, listave të leximit, procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0012443 datë 01.02.2022 dhe protokolit të verifikimit të njehsorit elektrik-mekanik në qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 6229 datë 19.07.2023 dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, kryesues

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

---

Arta Qorolli, anëtare

---

Adnan Preniqi, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit **S.K** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.